



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 01.04.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:04 dhe mbaroi në orën 11:54.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| <i>1. Ilir Rusi</i> | <i>(zëvendëskryetar)</i> |
| <i>2. Klodian Kurushi</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>3. Fatmira Luli</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>4. Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>5. Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>6. Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>7. Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| <i>8. Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>9. Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| <i>10. Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Elona Koleka, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.

3. Valbona Bako, Përgjegjëse pranë Sektorit të përgatitjes së dokumentacionit dhe përfaqësimit në gjykatë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator zoti Klodian Kurushi):

1.1 Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 585, datë 16.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Vlorë”.

1.2 Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.¹

Çështja e cila është për trajtim sot në rendin e ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi.

Fillimisht zoti Kurushi relaton relacionin shoqërues të projektvendimit “Për ndryshimin e pjesshëm të vendimit nr. 585, datë 16.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për caktim gjyqtari, në një çështje gjyqësore të veçantë, në Gjykatën e Apelit Vlorë.

“Mbi kërkesën nr. {...} prot., datë 03.12.2021, të Kryetares në detyrë të Gjykatës së Apelit Vlorë, për caktimin e një gjyqtari për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen plenare të datës 16.12.2021, ka shqyrtuar këtë kërkesë, e cila identifikonte si nevojë të kësaj gjykate, si më poshtë: (dhe lexohen të dhënat e paraqitura në tabelë).

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Për këtë kërkesë të kryetares në detyrë të Gjykatës së Apelit Vlorë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmit të skemës së delegimit dhe padobishmërisë së zbatimit të mekanizmit të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i ka propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatimin e nenit 170/1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të Vendimit të tij nr. 30, datë 14.02.2019, “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Më konkretisht, në konsideratë të kriterëve të përcaktuara në paragrafin IV, pika 5, të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, si dhe në zbatim të paragrafit VI, pika 4, të këtij Vendimi, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, ndër të tjera, ka propozuar:

1. Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë.

2. Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Po ashtu, në konsideratë të përcaktimeve të paragrafit VIII të Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar:

“1. Në shortimin e çështjes të përjashtohet gjyqtari i skemës së delegimit i caktuar pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i cili është caktuar më herët për gjykimin e çështjes, konkretisht:

a. Z. Sokol Pina.

2. Në shortimin e çështjes të përjashtohet gjyqtari i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, i cili ka pengesë për gjykimin e saj, konkretisht:

a. Z. Enton Dhimitri.”

Ndërsa, në konsideratë të përcaktimeve të paragrafit VIII, pika 3, të vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në

mënyrë të përhershme”, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka propozuar:

1. Në shortimin e çështjes, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe ngarkesës së ulët të saj, të mos përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i kësaj gjykate, konkretisht:

a. Z. Dritan Banushi.

Propozimet e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës u pranuan nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, ku mbi këtë bazë u zhvillua edhe procedura e shortit, për përzgjedhjen e 1 gjyqtari të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, për gjykimin e çështjes gjyqësore të identifikuar në tabelë me numër rendor 1, me objekt: “Përjashtim gjyqtari”.

Mbi këtë bazë, me vendimin nr.585, datë 16.12.2021, paragrafi IV, nënndarja “Gjykata e Apelit Vlorë”, pika 1, Këshilli i Lartë Gjyqësor, për kërkesën ka vendosur:

1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Irena Brahimi, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Federata e Sindikatave të Pavarura të Bashkuara të Shqipërisë; Objekti: “Sigurim padie”.

Mbas njoftimit të këtij vendimi, Gjykata e Apelit Vlorë, me shkresën nr.{...} prot., datë 18.03.2022, ka bërë me dije Këshillin e Lartë Gjyqësor se:

“...kërkesa ka qenë për çështjen civile nr.{...}, datë 16.02.2021 me objekt: “Përjashtim gjyqtari”.

Sa më sipër, rezulton që pavarësisht se në relacion objekti ka qenë i shënuar saktë “Përjashtim gjyqtari”, në hartimin e vendimit nr.585, datë 16.12.2021, si objekt të kërkesës është vendosur gabimisht “Sigurim padie”. Kjo ngatërresë ka ndodhur për shkak se Gjykata e Apelit Vlorë ndonëse në formularin e plotësuar për kërkesën për caktim gjyqtari në objektin e çështjes ka vendosur “Sigurim padie”, në shkresën përcjellëse ka shënuar se kërkohet caktimi i gjyqtarit për shqyrtimin e kërkesës me objekt: “Përjashtim gjyqtari”.

Në këto kushte, bazuar në nenet 113 dhe 117 të Kodit të Procedurave Administrative, si dhe në nenin 99 të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, është vendi për ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata e Apelit Vlorë”, paragrafi IV, i vendimit nr.585, datë 16.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, sa i përket objektit të çështjes për të cilin gjyqtarja është caktuar për gjykimin e çështjes

civile si më lart.

Sa më sipër, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata Apelit Vlorë”, paragrafi IV, faqe 2, të Vendimit Nr.585, datë 16.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në këtë mënyrë:

“1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Irena Brahim, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Federata e Sindikatave të Pavarura të Bashkuara të Shqipërisë; Objekti: “Përrjashtim gjyqtari”.

Hidhet në votim propozimi i ardhur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

(Anëtarët e Këshillit janë dakord me propozimin e Komisionit pra miratohet projektvendimi i ardhur nga Komisioni.)

Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi:

I. Ndryshimin e pikës 1, nënndarja “Gjykata Apelit Vlorë”, paragrafi IV, faqe 2, të Vendimit Nr.585, datë 16.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në këtë mënyrë:

“1. Gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Gjirokastër, Irena Brahim, caktohet në përbërje të trupit gjykues për të gjykuar për llogari të Gjykatës së Apelit Vlorë, çështjen gjyqësore me kërkues: Federata e Sindikatave të Pavarura të Bashkuara të Shqipërisë; Objekti: “Përrjashtim gjyqtari”.

II. Një kopje e vendimit t’i njoftohet kryetarit të gjykatës në nevojë dhe gjyqtarit përkatës të caktuar për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me publikimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Më tej zoti Kurushi relatton shkurtimisht relacionin sa i përket radhës së shortit duke i propozuar Këshillit që procedurat e shortit të ndiqen sipas kësaj radhe:

Gjykatat e shkallës së parë, sipas kësaj radhe:

Gjykatat e shkallës së parë sipas juridiksioneve të gjykatave të apelit me juridiksion të përgjithshëm:

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Shkodër: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë.

Gjykatat e shkallës së parë nën juridiksionin e Gjykatës së Apelit Gjirokastrë:
Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit administrativ:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë.

Gjykatat e apeleve, sipas kësaj radhe:

Gjykata Administrative e Apelit.

Gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm: Gjykata e Apelit Korçë; Gjykata e Apelit Shkodër; Gjykata e Apelit Gjirokastrë; Gjykata e Apelit Durrës.

Pasi anëtarët janë dakord me radhën e shortit, vijohet me relatimin e relacionit të parë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, seksioni penal.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, konkretisht: Z. Sokol Shehu.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe

kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Arbër Çela.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtarët Hasan Selimi dhe Arbër Çela.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Hasan Selimi dhe Arbër Çela.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të dytë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore, në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjes sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet gjyqtari që do të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Përmet.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve, si përjashtim nga rregulli, në kushtet e numrit të kufizuar të gjyqtarëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Përmet, të mos përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e saj, konkretisht: Znj. Yrfet Shkreli.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Marjola Beluli.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të tretë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, përfshirë dhe gjyqtarët e transferuar përkohësisht pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetari në detyrë i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, konkretisht: Z. Bevis Shehaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarja Ema Shaholli.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të katërt “Për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Apelit** ka paraqitur nevojë për 4 çështje gjyqësore (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Apelit, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, përfshirë dhe të atyre të skemës së delegimit të caktuar pranë këtyre gjykatave, të cilët plotësojnë kriteret për t’u caktuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart, të cilët janë në përbërje të Kolegjit Zgjedhor, që është thirrur në detyrë, referuar nenit 149/2 të Kodit Zgjedhor, konkretisht: Znj. {...}.

Në relacion është bashkëlidhur edhe lista me gjyqtarë të gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm dhe ata të skemës së delegimit të caktuar pranë tyre që plotësojnë kriteret për t’u caktuar pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, 2, 3, dhe 4 gjyqtari Sokol Ngresi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të pestë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Korçë** ka paraqitur nevojë për 9 çështje gjyqësore, 2 në lëndë civile dhe 7 penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Gjirokastrë, përfshirë edhe gjyqtarin e skemës së delegimit.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë i Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, konkretisht: Z. Dritan Banushi.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtar Sokol Pina.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Irena Brahim.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Sokol Pina (relator), Enton Dhimitri dhe Irena Brahim (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtari Sokol Pina.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtari Enton Dhimitri.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Irena Brahim.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtari Enton Dhimitri (relator), Sokol Pina dhe Irena Brahim (anëtarë).

Për çështjen nr. 5, penale, gjyqtarët Sokol Pina dhe Enton Dhimitri.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të gjashtë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Shkodër”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Shkodër** ka paraqitur nevojë për 3 çështje gjyqësore, 1 në lëndë civile dhe 2 në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Shkodër, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen me short gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Durrës, përshtirë edhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë kësaj gjykate.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohet për gjykimin e 3 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 1.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes së tretë të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Durrës: Anita Mici, Valbon Çekrezi dhe Irida Kacerja; pasi dy të parët janë aktualisht pjesë e trupit gjykues të kësaj çështjeje, ndërsa Irida Kacerja ka pengesë ligjore për t’u caktuar në short si anëtare e tretë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtari Florjan Kalaja.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtari Valbona Çekrezi.

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtari Valbon Çekrezi.

Shorti i mësipërm ripërsëritet pasi nga sistemi elektronik janë marrë për shortim dy gjyqtarë, ndërsa sipas propozimit të ardhur nga Komisioni, për të tre çështjet duhet të përzgjidhej një gjyqtar.

Pas ripërsëritjes së shortit, rezulton:

Për çështjet nr. 1, 2 dhe 3, gjyqtari Florjan Kalaja.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të shtatë “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Gjirokastrë”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Gjirokastrë** ka paraqitur nevojë për 10 çështje gjyqësore, 8 në lëndë civile dhe 2 në lëndë penale (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 10 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Vlorë, përfshirë dhe gjyqtarët e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 10 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjeve të përjashtohet nga shorti kryetarja e Gjykatës së Apelit Vlorë, konkretisht: Znj. Iliba Bezati.

Në shortimin e çështjeve të veçanta, përjashtohen nga shorti gjyqtarët z. Sokol

Ngresi dhe z. Laurent Fuçia, sipas përcaktimit në relacion, duke qenë se kanë pengesë ligjore për t'u rishortuar edhe një herë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Genti Dokollari.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtari Engert Pëllumbi.

Për çështjen nr. 1, civile, gjyqtarja Margarita Buhali.

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtari Genti Dokollari.

Për çështjen nr. 6, civile, gjyqtari Engert Pëllumbi.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarët Margarita Buhali dhe Genti Dokollari.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtari Engert Pëllumbi.

Për çështjen nr. 7, civile, gjyqtarja Margarita Buhali.

Për çështjen nr. 10, penale, gjyqtari Genti Dokollari.

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtari Engert Pëllumbi.

Më pas vijohet me relatimin e relacionit të fundit “Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Durrës”.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata e Apelit Durrës** ka paraqitur nevojë për 9 çështje gjyqësore, 5 në lëndë penale dhe 4 në lëndë civile (lexohen të dhënat e çështjeve sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Durrës në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Sa më sipër, propozimet e Komisionit janë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Shkodër, përfshirë dhe gjyqtarin e skemës së delegimit të caktuar pranë saj.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 9 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti kryetari i Gjykatës së Apelit Shkodër, konkretisht: Z. Fuat Vjerdha.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 4, civile, gjyqtari Tonin Stërkaj.

Për çështjen nr. 2, civile, gjyqtarja Valbona Vata.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 5, civile, gjyqtari Tonin Stërkaj.

Për çështjen nr. 7, penale, gjyqtarja Valbona Vata.

Për çështjen nr. 6, penale, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Për çështjen nr. 8, penale, gjyqtari Tonin Stërkaj.

Për çështjen nr. 3, civile, gjyqtarja Valbona Vata.

Për çështjen nr. 9, penale, gjyqtarja Vojsava Osmanaj.

Me kaq mbyllen procedurat e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor